



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. _____ Prot

Date 16 /08/2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

[Data 16.08.2024

Drejtuar: RRODHE-CONSTRUCTION sh.p.k me nipt L43123001J me adrese Berat Otlak DUSHNIK Fshati Dushnik, lagjja " Parangua ", godine nje kateshe nr.15 , zona kadastrale nr.1587, me numer pasurie 1557

Procedura e prokurimit/lotit: **PROÇEDURË E HAPUR E THJESHTUAR - pune**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-: 12891-07-11-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **NDERHYRJE REHABILITUESE NE MURE MBAJTESE DHE TERRENE NE TERRITORIN E BASHKISE NE KUADER TE MBROJTJES CIVILE**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: brenda 2 muajve nga lidhja e kontrates.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 37 datë 15 Korrik 2024 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **AIDA CONSTRUCTION me Nipt M03116403L** oferta e operatorit ekonomik 9 409 636 (nëntë milion e katërqindë e nëntëmijë e gjashtëqindë e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

2. **RRODHE – CONSTRUCTION SHPK me Nipt L43123001J** oferta e operatorit ekonomik 9 417 245 (nëntë milion e katërqindë e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqindë e dyzetë e pesë) lekë pa tvsh.

3. **VELLEZERIT KUKA me Nipt J63423440Q** oferta e operatorit ekonomik 10 500 480 (dhjetë milion e pesëqindë mijë e katërqindë e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar një operator ekonomik.

AIDA CONSTRUCTION me Nipt M03116403L

Bazuar në VKM nr.710 datë 24.11.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26, në paragrafin e parë të pikës 6 *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat a, b, d, dh, e, h, i, j të pikës 2, të këtij neni si dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

Operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin e vetëdeklarimit, dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës me nr. 4237 prot. Dt. 02.08.2024

Nga kontrolli fizik i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik si më lartë, rezultojnë këto mangësi :

1. Operatori ekonomik ka paraqitur Çertifikatë kursi të veçantë nga AKPA, çertifikata është lëshuar nga Drejtoria rajonale e ofrimit të formimit profesional publik Gjirokastrë, dhe rezulton për dy punonjës të çertifikuar si karpentier, të ketë numër amze të njëjtë, konkretisht për Z. Viron Mara Nr. amze 90 me datë lëshimi 18.10.2022, dhe Z. Izet Demollaj Nr. amze 90 me datë lëshimi 26.10.2022, komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nuk është i saktë, pasi brenda institucionit numri i amzës është unik vetëm për një person. Si edhe nga verifikimi i listëpagesës të muajit qershor të paraqitur nga operatori ekonomik Z. Izet Demollaj figuron suvates.
2. Operatori ekonomik ka paraqitur çertifikata trajnimi për punonjësit saldator Z. Taip Hoxhallari dhe Z. Zyni Beqiraj, çertifikatat e lëshuara nga Mondo Saldatura Srl janë në gjuhë të huaj, të pa përkthyer dhe të pa noterizuara. Çertifikatat e lëshuara nuk rezultojnë të jenë të liçensuara sipas kërkesave të pikës 2.3.4 të DST-së. Nga verifikimi i listëpagesës të muajit qershor Z. Taip Hoxhallari figuron bojaxhi, dhe Z. Zyni Beqiraj figuron punëtor ndihmës.
3. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e taksave vendore për vitin 2024 ku ka ushtruar aktivitetin sipas QKB, konkretisht në Bashkinë Fier, Himarë, Patos dhe Roskovec

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos skualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik dhe njofton operatorin e renditur të rradhës me njoftimin për dorëzimin e dokumentave të vetëdeklarimit.

* * *



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë RRODHE-CONSTRUCTION sh.p.k me nipt L43123001J me adrese Berat Otlak DUSHNIK Fshati Dushnik, lagjja " Parangua ", godine nje kateshe nr.15 , zona kadastrale nr.1587, me numer pasurie 1557, me oferte ekonomike 9 417 245 (nëntë milion e katërqindë e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqindë e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH. [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Ervin DEMO

Konc: F.Arapi
Miratoi : P.Sinjari